



UDHËZUES I  
RAMAZANIT  
PËR  
MUSLIMANIN E  
RI

DHE ATË QË AGJËRON PËR  
HERË TË PARË



بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ



Titulli original:

**"New muslim Ramadan Guide"**

Autor:

**Komiteti i Thirrjes Elektronike - komitet avokues dhe arsimor i lidhur me  
Shoqatën Bamirëse Al-Najat, Kuvajt**

Solli në gjuhën shqipe:

**Hekuran Helshani**

Boton:

**Literaturaislame.com**





## Udhëzues i Ramazanit për muslimanin e ri

### Çfarë është agjërimi?

Agjërimi në Kuran (në gjuhën arabe) quhet “savm”, e që fjalë për fjalë do të thotë të abstenosh nga diçka. Në suren Merjem, Allahu na tregon për Merjemen, nënën e Isait, se ajo tha:

**“Unë jam betuar në të Gjithëmëshirshmin se do të agjëroj (savm), prandaj sot nuk do të flas me askënd.” (Merjem, 26)**

Kuptimi i kësaj është: “Jam betuar se nuk do të flas me askënd sot”. Ndërkaq, në kuptimin sheriatik, fjala “savm” do të thotë të përmbahesh nga të gjitha gjërat që janë të ndaluara gjatë agjëritit, nga agimi deri në perëndim të diellit, dhe ta bësh këtë me qëllim të agjëritit.

### Pse agjërojnë muslimanët?

Kurani thotë:

**“O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, ashtu që të mund të bëheni të devotshëm.” (Bekare, 183)**

Takva (devotshmëria) është një term shumë i rëndësishëm shpirtëror dhe etik i përmendur në mënyrë të përsëritur në Kuran. Është shuma totale e gjithë shpirtërores dhe etikës islame. Është një vlerë në jetën e një besimtari që e mban atë të frikësuar nga Zoti gjatë gjithë kohës.

Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë se agjërimi është mburojë. Ai e mbron personin nga mëkati dhe dëshirat epshore.



Kur dishepujt e Jezusit (Isait a.s.) e pyetën se si t'i dëbonte shpirtrat e këqij, thuhet se ai tha: "Por ky lloj nuk del kurrë përveçse me lutje (namaz) dhe agjërimit." (Mateu 17:21)

### **A është çështja vetëm te durimi i urisë dhe etjes?**

Qëllimi i agjërimit nuk është trajnimi fizik për të duruar urinë, etjen dhe rraskapitjen; përkundrazi, është disiplinimi i egos për të hequr dorë nga të dashurat për hir të të dashurit. Të dashura janë dëshirat për të ngrënë, pirë, marrëdhënie intime, etj, ndërsa i dashur është Allahu i Lartësuar.

Prandaj, është e domosdoshme të kemi parasysh kur agjërojmë që ta bëjmë këtë vetëm për hir të Allahut. Është e domosdoshme për ne që të përpiqemi të bëjmë më të mirën për të zbatuar veprat që pasqyrojnë bindjen tonë ndaj Allahut, të tilla si: përkujtimi i Allahut, leximi i Kuranit, namazet vullnetare, veprat bamirëse dhe lëmoshat, sjelljet e mira.

Kur një musliman qëndron në këtë gjendje gjatë gjithë kohës, në muajin e Ramazanit, ai patjetër do të dalë një musliman më i mirë.

---

Burimi: onislam.net.





## Fillimi dhe fundi i Ramazanit

### Si t'i vërtetojmë?


Ka shumë hadithe në lidhje me kohën e Ramazanit. Është transmetuar në mënyrë autentike se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë:

***“Filloni të agjëroni me ta parë atë (d.m.th. hënën) dhe përfundoni agjërimin pasi ta keni parë atë. Nëse është (mot) me re apo mjegull, atëherë plotësojeni muajin Shaban tridhjetë (ditë)”***.

Dijetarët janë në ujdi se mënyra legjitime për të konfirmuar fillimin dhe fundin e muajit në Sheriatin Islam është, ose duke parë hënën e re, ose plotësimi i muajit të mëparshëm 30 ditë.

### Muslimanët në vendet jomuslimane

Muslimanët që jetojnë në vende të tilla duhet të bëjnë çmos për të parë hënën e re në zonat e tyre. Ka shumë organizata myslimane në ato vende që ofrojnë shërbime për komunitetet muslimane në lidhje me shikimin e hënës së re.






Nëse ata nuk mund ta shohin hënën e re për një arsye ose tjetër, në atë rast, ata duhet të ndjekin shikimin e një vendi musliman. Ose, sipas një mendimi tjetër të dijetarëve, ata duhet të ndjekin shikimin e vendit më të afërt musliman me ta.

Në disa vende dita është rreth 21 orë në verë dhe 3 ose 4 orë në dimër. Dijetarët kanë thënë se, ata tek të cilët ekziston nata dhe dita brenda periudhës 24 orëshe, duhet të agjërojnë gjatë orëve të ditës dhe të falin namazet ditore në kohën e caktuar, sepse Allahu thotë:

**“Namazi është detyrë për besimtarët në kohë të caktuar.”** (Nisa, 103), pavarësisht sa e gjatë apo e shkurtër është dita.

Megjithatë, ka vende të tjera ku dita nuk dallohet nga nata. Për këtë, këshilli i lartë i dijetarëve të mëdhenj në Arabinë Saudite është mbledhur dhe ka diskutuar këtë çështje, me ç’rast ka nxjerrë edhe vendimin e mëposhtëm:

“Njerëzit që jetojnë në vendet ku dita zgjat gjashtë muaj gjatë verës dhe nata zgjat gjashtë muaj gjatë dimrit, është obligohen që të kryejnë namazet ditore brenda një periudhe 24-orëshe, duke vlerësuar oraret e saj, duke marrë si model vendin më të afërt në të cilin ka ditë e natë dhe kanë orar të rregullt të namazit. Kjo sipas hadithit fisnik në të cilin Allahu i tha Profetit: **“O Muhamed. Ato janë pesë namaze gjatë ditës dhe natës”**.







Gjithashtu është transmetuar autentikisht se Profeti ﷺ ka thënë në hadithin e Dexhallit, me t'u pyetur se sa do të qëndrojë Dexhalli në tokë, ai tha: “40 ditë. Një ditë që zgjat një vit, një ditë një që zgjat një muaj, një ditë që zgjat një javë, dhe ditët e tjera si ditët tuaja (të zakonshme)”. Më tej u pyet: “A do të mjaftonte që ne të falnim vetëm pesë namaze gjatë asaj dite që zgjat një vit?” Ai tha: “Jo, vlerësojeni kohën!”

“Profeti nuk e konsideroi ditën që do të zgjat një vit si një ditë e vetme. Përkundrazi, ai udhëzoi që pesë namazet ditore duhet të falen çdo 24 orë.

Në mënyrë të ngjashme, agjërimi duhet të respektojë vendet e përmendura më sipër sipas kohës standarde të vendit më të afërt me to, ku ka ditë dhe natë.

---

Burimi: [missionislam.com](http://missionislam.com).





## Si të përgatitemi për Ramazan?

Çdo musliman duhet të përgatitet për të mirëpritur muajin e bekuar të Ramazanit duke forcuar raportet e tij me Kuranin dhe duke rimbushur baterinë e tij shpirtërore për t'u përgatitur për ta bërë të gjithë muajin e bekuar të Ramazanit një rast të vërtetë të bindjes së sinqertë.

Ramazani është një ngjarje që ndodh në jetën e atyre që besojnë, qoftë si individë, qoftë si umet (komunitet), një herë në vit. Allahu e bëri atë për të na ndihmuar të bëhemi të devotshëm (takva) dhe kështu të na përgatisë për misionin madhështor të realizimit të vullnetit të Tij në tokë.

Thuhet se: "Rexhebi është muaji i mbjelljes së farës, Shabani është muaji i ujitjes së farës, kurse Ramazani është sezoni i korrjes". Prandaj, mendoni për atë që dëshironi të korni në Ramazan dhe filloni ta mbillni dhe të kujdeseni për të në Rexheb dhe Shaban.

Ja ku e kemi një dua të famshme të Pejgamberit Muhamed (në lidhje me këtë):

"O Allah na dhuro bekimet e muajit Rexheb dhe Shaban dhe na mundëso të arrijmë Ramazanin!" (Ahmedi)  
Gjatë Shabanit kujtojeni vetes dhe familjes suaj virtytet e agjërimit. Bëni të paktën një seancë javore me gruan/burrin dhe fëmijët tuaj për të folur për rëndësinë e agjërimit. Merrni një broshurë që flet rreth agjërimit dhe lexojeni atë me fëmijët tuaj për t'i bërë ata ta duan agjërimin.






Përqendrohuni në virtytet e Ramazanit, se ai është muaji gjatë të cilit është shpallur Kurani dhe se ky muaj përmban Natën e Kadrit që është më e mirë se një mijë muaj.

Muslimanët e hershëm lexonin shumë Kuran në Shaban, si përgatitje për Ramazanin. Ata gjithashtu jepnin lëmoshë në Shaban për të ndihmuar të varfrit dhe nevojtarët, që të kishin mundësi të agjëronin gjatë Ramazanit. Ata gjithashtu i luteshin Allahut që t'i bekonte në muajt Rexheb, Shaban dhe Ramazan.

Kjo do të thotë se çdo musliman duhet që duanë (lutjen drejtuar Allahut) ta bëjë një mjet të fortë për të përfituar sa më mirë nga Ramazani. Duhet të fillohet me lutje para Ramazanit, për ju dhe për të tjerët, që Allahu t'jua pranojë duatë, kurse pas Ramazanit që Zoti do t'jua pranojë agjërimin dhe do t'ju shpërblejë me bollëk për të.

Le t'i lutemi Allahut që të dalim nga Ramazani me besim të rimbushur, duke fituar forcë në besimin dhe përkushtimin tonë, si dhe raportet tona me Allahun e Lartësuar.





## Si mund ta bëj këtë Ramazan një pikë referimi?

Çdo musliman duhet të bëjë çmos që muaji i ardhshëm i Ramazanit të bëhet një ngjarje kalendarike e vitit.

Vendosni një objektiv për veten tuaj, si për shembull falja e të gjitha mëkateve tuaja nga Allahu dhe se shpëtimi nga Zjarri i Xhehenemit.

Pyete veten a je i kënaqur me atë që bërë Ramazanin e kaluar? A do të jetë ky Ramazan si i vitit të kaluar? Le të jetë ky Ramazan fillimi i ndryshimit të vërtetë. Bëjeni këtë Ramazan të ndryshëm nga të mëparshmit. Filloni të praktikoni një akt adhurimi që nuk e keni bërë kurrë më parë, ose rritni aktet e adhurimit që tashmë i bëni.

Nëse keni lexuar Kuranin një herë gjatë muajit të Ramazanit, këtë vit lexoni atë dy herë. Nëse më parë e keni falur taravinë (namazin e natës në Ramazan) i vetmuar, këtë vit faleni me xhemat. Nëse nuk keni dhënë sadaka, këtë vit bëjeni zakon të përditshëm t'u jepni nevojtarëve atë që keni mundësi, qoftë edhe një sasi të vogël.

Nëse nuk keni agjëruar vullnetarisht që nga Ramazani i fundit, stërvituni që të agjëroni gjatë muajit Shaban siç bënte Profeti ﷺ.





## Ramazani im i parë

Nëse e keni përqafuar Islamin diku nga viti i kaluar, atëherë me siguri po përgatiteni pikërisht tani për Ramazanin tuaj të parë. Nëse nuk jeni rritur me ekspozim ndaj kulturave muslimane, atëherë mund të zbuloni shumë zakone, tradita, veshje dhe ushqime të reja këto ditë. Shpresojmë se do të bëni shumë miq të rinj, përveç gjithë atyre përfitimeve dhe bekimeve shpirtërore që vijnë me muajin e agjërimit.

Por, ndërkohë që shumë muslimanë presin me padurim muajin e Ramazanit paraprakisht, nëse për ju ky është i pari, ju mund të ndiheni në ankth - kështu që unë do të doja t'ju ofroj disa këshilla për t'ju ndihmuar paraprakisht në lehtësimin e çdo shqetësimi që mund të keni.





- Lavdërojeni shumë Allahun që ju udhëzoi në Islam dhe ju zgjati jetën për të dëshmuar këtë Ramazan.
- Bëje nijet qysh në fillim të Ramazanit ta agjërosh këtë muaj për hir të Allahut, duke kërkuar falje prej Tij.
- Shfrytëzojeni kohën tuaj me adhurime të ndryshme, duke përfshirë përmendjen e Allahut (dhikrin), leximin e Kuranit, faljen e namazeve të obligueshme dhe vullnetare dhe jepni sadaka për hir të Allahut.
- Ji i kujdesshëm që të marrësh pjesë në tubimet e muslimanëve, qoftë për namazet me xhemat apo për ligjërata të ndryshme.
- Mund të përjetoni lodhje të madhe në ditët e para, për shkak të qëndrimit të gjatë pa ngrënë dhe pirë, por gjithmonë keni parasysh që këtë e bëni duke kërkuar kënaqësinë e Allahut dhe Xhenetin.
- Përpiqu të bësh një umre (haxhin e vogël) në Ramazan, ngase ka shpërblim të madh.
- Le të jetë Ramazani një mundësi e mirë për të reflektuar mbi Kuranin, për të thithur kuptimet e tij, për të zbuluar thesaret e tij dhe për të mësuar vlerat e tij.
- Qëllimi i agjërit është pastrimi i vetvetes, andaj përpiqu ta shfrytëzosh këtë mundësi.





## Mirë se vjen Ramazan!

Muaji i Ramazanit është shumë i çmuar nga ana e Allahut, Pejgamberit të Tij, si dhe nga muslimanët nëpër breza. Në Kuran, Allahu e përmend Ramazanin me emër dhe i referohet atij në ajete të ndryshme. Allahu thotë:

***“Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja). Pra, kushdo nga ju që dëshmon këtë muaj, le të agjërojë! Sa i përket atij që është i sëmurë ose gjendet në udhëtim e sipër (le të agjërojë më vonë) aq ditë sa nuk i ka agjëruar. Allahu dëshiron që t’ju lehtësojë dhe jo që t’ju vështirësojë. Ai dëshiron që të plotësoni numrin e ditëve të agjërimit dhe që ta madhëroni Allahun (në fund të agjërimit), për shkak se ju ka drejtuar në rrugë të drejtë e që ta falënderoni Atë.”*** (Bekare, 185)

Muaji i Ramazanit është muaji i Kuranit, agjërimit, përmendjes së Allahut, itikafit (qëndrimi në xhami për adhurim), vizitës mes muslimanëve, përgatitjes së zemrës për të përfituar nga drita e këtij muaji. Profeti ﷺ i thoshte këto fjalë kur muaji Shaban i afrohej fundit:





**“O njerëz, ju ka ardhur Ramazani, muaj i bekuar. Allahu jua ka obliguar agjërimin e këtij muaji. Në këtë muaj hapen dyert e Xhennetit, mbyllen dyert e Xhehenemit, lidhen në pranga shejtanët....”** (Nesaiu)

Pejgamberi ﷺ na nxiti të agjërojmë, jo vetëm nga ushqimi dhe pija, por edhe të përmbahemi nga çdo sjellje e keqe, qoftë ajo kundër vetes, shoqërisë apo njerëzimit në përgjithësi. Sikur muslimanët ta dinin vërtet vlerën e Ramazanit në sytë e Allahut, ata do të dëshironin që i gjithë viti të ishte Ramazan.

## Bekimet e Ramazanit

Ramazani është një muaj madhështor. Është muaji i Kuranit dhe në të ndodhet Nata e Kadrit, e cila është më e mirë se njëmijë muaj. Allahu zgjodhi këtë muaj dhe një natë të veçantë në këtë muaj për t'i dhënë hijeshi njerëzimit me testamentin e Tij të fundit, mesazhin e Tij të fundit, Kuranin. Në këtë muaj kemi një nxitje dhe dëshirë më të madhe për të bërë vepra të mira sepse ky muaj është i mbushur me virtyte dhe bekime. Profeti ﷺ ka thënë për këtë muaj:







***“Kur vjen Ramazani, djajtë dhe xhinët rebelë vihen në zinxhirë dhe dyert e Xhehenemit mbyllen, asnjë prej tyre nuk mbetet e hapur. Dyert e Xhenetit janë të hapura dhe asnjë prej tyre nuk mbetet e mbyllur. Dhe një thirrës thërret: “O kërkues i së mirës shpejto në vepra të mira, dhe o kërkues i së keqes largohu nga të këqijat. Ndërsa çdo natë Allahu liron nga Zjarri robër të Tij.” Ky lajmërim përsëritet çdo natë.”*** (Tirmidhiu)

Qëllimi i Ramazanit është stërvitja jonë morale dhe shpirtërore dhe pastrimi i trupave, mendjeve dhe shpirtave tanë. Është një program trajnimi vjetor për të gjithë besimtarët. Është sezonë e veçantë për t'iu afruar Allahut dhe për të kërkuar bekimet dhe mirësitë e Tij. Është kohë për të mësuar takvanë (frikën ndaj Zotit), devotshmërinë, vetë-disiplinën dhe durimin. Është kohë për të dhënë më shumë lëmoshë dhe për t'u bërë më bujarë. Është kohë për të kërkuar falje nga Allahu dhe për të falur njëri-tjetrin. Është kohë për të falënderuar Allahun për dhuratat dhe mirësitë e Tij dhe veçanërisht dhuratën e imanit (besimit).

Ju bëj thirrje vëllezërve dhe motrave të mia, të mos humbisni asnjë ditë agjërimi dhe të mos humbisni asnjë moment të muajit të bekuar të Ramazanit. Kjo është një kohë shumë e çmuar dhe Allahu do të na japë shumë përfitime nëse e përdorim atë në mënyrën e duhur.

Le të mbajmë në mendje gjërat e mëposhtme kur e kemi në konsideratë këtë muaj:

### **1 - Qëllimi (nijeti):**

Kujtojani vetes vazhdimisht se jeni duke agjëruar për t'iu bindur Allahut të Lartësuar. Jini të sigurtë në qëllimin tuaj. Ju dëshironi që Allahu t'jua pranojë agjërimin. Profeti ﷺ ka thënë: “Kush e agjëron Ramazanin me besim dhe duke shpresuar shpërblimin e Allahut, atij i falen të gjitha mëkatet e kaluara.” (Buhariu)



## 2 – Pasimi i Sunetit:

Respektoni Sunetin në agjërim. Hani syfyr pak para agimit dhe përfundoni agjërimin me perëndim të diellit. Përpiquni sa të keni mundësi të agjëroni aq sa ka agjëruar Profeti Muhamed (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!) Nuk kishte namaz më të mirë se namazi i tij dhe nuk kishte agjërim më të mirë se agjërimi i tij. Mundohuni të ndiqni mënyrën e tij të agjërimit. Kjo është mënyra më e pranueshme e agjërimit tek Allahu i Lartësuar.

## 3 – Devotshmëria:

Mbani trupin dhe mendjen tuaj shumë të pastër. Agjërimi nuk është vetëm shmangie e ushqimit dhe pijeve. Agjërimi është të mësosh se si të shmangësh fjalët e këqija dhe veprat e këqija. Pejgamberi ﷺ ka thënë: "Kush nuk i braktis fjalët e këqija dhe veprat e këqija, Allahu nuk ka nevojë që i këtilli ta lë ushqimin dhe pijen". (Tirmidhiu)

## 4 – Kurani:

Agjërimi dhe shpallja janë të ndërlidhura. Profeti Musa (Moisiu) agjëroi gjatë kohës kur iu shpall Tevrati. Profeti Isa (Jezusi) agjëroi gjatë kohës kur iu shpall Ungjilli, dhe Profeti Muhamed ﷺ agjëroi kur mori mesazhin e parë të Kuranit. Le të bëjmë të njëjtën gjë. Ju duhet të agjëroni dhe të kaloni më shumë kohë me Kuranin. Lexoni Kuranin çdo ditë. Përpiquni të përfundoni të paktën një herë të gjithë Kuranin gjatë këtij muaji, me leximin tuaj personal.

## 5 – Namazi, lutja dhe dhikri:

Faluni në kohë dhe kryeni të gjitha namazet. Mos injoroni namazet e teravive. Bëni më shumë namaze vullnetare.



Bëni adhurime sa të mundeni. Bëni më shumë dhikër (përmendje të Allahut) dhe dua (lutje) për veten dhe për të tjerët. Pendohuni dhe kërkoni falje për veten dhe për të tjerët sa të mundeni. Kjo është koha më e mirë për përkushtim dhe për të kërkuar falje nga Allahu. Kërkoni Natën e Kadrit me përkushtim të veçantë gjatë dhjetë netëve të fundit të këtij muaji.

#### **6 – Zekati, sadakaja dhe bamirësia:**

Ramazani gjeneron një shpirt që jep dhe sakrifikon. Kur e privojmë veten nga ushqimi dhe pijet, kuptojmë mirë se çfarë do të thotë të jesh i uritur dhe i etur. Ne e kuptojmë dhimbjen e atyre që nuk mund të sigurojnë nevojat themelore për jetesë. Jini shumë bamirës dhe bujarë. Jepni më shumë për të ndihmuar të varfrit dhe nevojtarët. Kontribuoni bujarisht në projekte të dobishme sociale dhe komunitare.

#### **7 – Familja:**

Mirësia duhet të fillojë në shtëpi. Jini shumë bamirës së pari me familjen tuaj, familjen e ngushtë dhe familjen e gjerë. Kaloni më shumë kohë, madje kohë cilësore, me anëtarët e familjes tuaj. Mundohuni të hani syfyr së bashku. Prisni agjërimin së bashku dhe faluni së bashku, sa të keni mundësi. Shpeshtojeni këtë zakon gjatë këtyre ditëve. Ramazani duhet t'ju afrojë me njëri-tjetrin. Mëshira e veçantë e Allahut bie pikërisht mbi familjet e bashkuara, harmonike dhe paqësore.

#### **8 – Sjellja e mirë:**

Agjërimi duhet t'ju transformojë dhe duhet t'ju bëjë tjetër person. Mundohuni të jeni tepër të sjellshëm dhe të edukuar gjatë këtij muaji. Harrojini grindjet dhe mosmarrëveshjet mes vete. Pajtohuni dhe falni. Mos u përfshini në përgojim, gënjeshtër, mashtrim dhe çdo gjë që është mëkat. Jini shumë të mirë me muslimanët dhe me të gjithë njerëzit. Jini të mirë me miqtë dhe fqinjët tuaj.



Bëjini fqinjët dhe kolegët tuaj jomuslimanë ta kuptojnë se me të vërtetë kjo periudhë kohore është koha juaj e bekuar dhe e shenjtë.

### **9 – Reflektimi:**

Mendoni, reflektoni dhe planifikoni për të përmirësuar gjendjen morale dhe shpirtërore të vetes suaj dhe të familjes suaj. Mendoni për gjërat dhe mëkatet e gabuara që mund të bëni dhe vendosni të korrigjoni vetveten. Mendoni për ndonjë mangësi që keni në vlerat tuaja islame. Planifikoni të ndryshoni vetveten. Mendoni se çfarë mund të bëni për Umetin dhe njerëzimin për ta bërë këtë botë një vend më të mirë për të gjithë. Mendoni për jetën pas vdekjes dhe Ditën e Gjykimit.

### **10 - Bëhu gazmor dhe i lumtur:**

Ramazani nuk është kohë zie apo pikëllimi. Është një kohë falënderimi ndaj Allahut. Në një hadith transmetohet se Profeti (paqja qoftë mbi të) ka thënë: “Kur të agjëroni, maskohuni. Le të mos duken tek ju shenjat e agjërit”. (Buhariu në “El-Edeb el-mufrad”)

Mos u ndjeni të lodhur dhe të rraskapitur. Ndrehuni vigjilent dhe relaksohuni. Merrini gjërat me lehtësi. Kjo kohë është për të mirën tuaj. Jepini njëri-tjetrit urimet e Ramazanit dhe shijoni këtë kohë të bukur.

### **Si të korrin bekimet e këtilla?**

Mos harroni asnjëherë se në Ramazan shpërblimet shumëfishohen, dyert e Xhenetit hapen, dyert e Zjarrit mbyllen, dhe mëkatet falen. Jini të sigurt në mëshirën e Allahut për muslimanët që agjërojnë me besnikëri dhe shmangin kryerjen e mëkateve plotësisht.



Për ta bërë Ramazanin muajin më të mirë të vitit, përkujdesuni që:

1. Të forconi besimin tuaj gjatë këtij muaji duke konfirmuar besimin tuaj në njëshmërinë e Zotit.
2. Kini qëllimin për të kënaqur Zotin me të gjitha aktet tuaja të adhurimit.
3. Largohuni nga gjërat që e dëmtojnë besimin tuaj.
4. Ndiqni gjurmët e Profetit Muhamed ﷺ.
5. Ushqeni të varfrit dhe nevojtarët, duke ndjerë kështu mirësinë e dhënies në Ramazan.
6. Para se të vijë namazi i Bajramit, sigurohuni që ta keni paguar zekatin e fitrit.
7. Falni namazet e përditshme në kohën e tyre të caktuar dhe me xhemat. Merrni pjesë vazhdimisht në namazin e taravisë dhe kryeni namaze shtesë. Rizbulojeni fuqinë e namazit në Ramazan dhe përqendrohuni shumë gjatë lutjes. Lëreni jetën e kësaj bote pas shpine pasi të keni ngritur duart për namaz dhe të keni thënë Allahu Ekber (Allahu është më i madhi).
8. Vizitoni anëtarët e familjes dhe të afërmit tuaj.
9. Kujdesuni për itikafin (qëndrimin në xhami) gjatë dhjetë ditëve të fundit të Ramazanit, nëse mundeni.
10. Bëje Kuranin shokun tënd në Ramazan dhe ke për qëllim të mbarosh së paku një herë leximin e tij.
11. Bëje nijet që t'i kthehesh Allahut me pendim të sinqertë.
12. Bëje nijet që t'i përmirësosh sjelljet tuaja dhe mënyrën se si i trajton të tjerët.
13. Bëj çdo përpjekje për davet gjatë Ramazanit nëse mundesh, si: shpërndarja e materialeve të thirrjes në Islam që kanë të bëjnë me Ramazanin (CD, broshura, video, skedarë PDF, etj.).



**14.** Nëse keni mundësi financiare, bëni iftar për muslimanët e rinj në komunitetin tuaj, për t'i ndihmuar ata të integrohen me bashkëmoshatarët e tyre muslimanë. Ju gjithashtu mund të ftoni jomuslimanët në ngjarje të tilla për t'i njohur ata dhe për t'u prezantuar Islamin përmes agjërimit.

**15.** Bëni iftar dhe dhurata për jetimët dhe fëmijët e braktisur për ta bërë Ramazanin një ndodhi lumturie për ta.

**16.** Përgatitni listën tuaj të duave (lutjeve). Shkruani duatë që dëshironi të recitoni gjatë gjithë muajit. Ju mund t'i kërkonit Zotit çdo gjë dhe gjithçka. Zgjidhni kohën dhe rastet e përshtatshme për të bërë dua. Lutja më e mirë është gjatë sexhdes, gjatë faljes së namazit të natës vonë, në ditët e fundit të Ramazanit dhe gjatë Natës së Kadrit.

Jepini përparësi listës suaj të lutjeve. Kushtoni rëndësi etikës së lutjes: fillojeni lutjen tuaj me lavdërimin e Zotit dhe dërgimin e salavateve (paqes dhe bekimeve të Allahut) për Profetin Muhamed; Drejtohuni nga kibla (drejtimi i Qabes) dhe ngrini duart lart. Jini të sigurt që Zoti nuk do të lejojë kurrë që duart tua të kthehen bosh kur i luteni Atij. Mos i harroni në lutje popujt e shtypur.

I lutemi Zotit që të na lejojë të jetojmë deri në Ramazanin e ardhshëm dhe ta bëjmë atë Ramazanin më të mirë ndonjëherë.



## Përfitimet nga agjërimi

### Përfitimet psikologjike:

Çdo ves në shoqëri buron nga mungesa e vetëkontrollit. Qoftë dhunë, varësi, bixhoz, tradhti apo marrëdhënie seksuale para martesës. Të gjitha janë rezultat i nënshtrimit ndaj dëshirave. Kur një person nuk e ka forcën në karakterin e tij për t'i bërë ballë tundimeve të shumta dhe për ta rrëzuar nefsën (unin) e tij përtokë, atëherë ai do të bëhet me siguri skllav i këtyre dëshirave. Si i burgosur nga dëshirat, një person ndihet plotësisht i pafuqishëm, i mungon çdo aftësi për të ndihmuar veten. Në rastet ekstreme, këta individë bien në depresion, vetëvrasje, falimentim, burg ose në ndonjë skandal.

Meqenëse burimi i gjithë kësaj të keqeje është paaftësia për të kontrolluar veten, atëherë do të ishte e një rëndësie të madhe që të ekzistojnë seanca trajnimi për shoqërinë në tërësi, në mënyrë që të forcohet vullneti i tyre dhe të shmangen këto gracka shkatërruese që ndikojnë negativisht tek të gjithë. Fatmirësisht, në botën myslimane ka një seancë të tillë trajnimi gjatë muajit të bekuar të Ramazanit.






Çdo musliman që agjëron kalon nëpër një stërvitje intensive për t'i bërë ballë llojeve të ndryshme të tundimeve. Tundimi për të ngrënë, për të pirë, për të pasur marrëdhënie, apo edhe për t'u zemëruar, kapërcehet çdo ditë, për një muaj rresht, gjë që na përgatit për sprovat e shumta e të vështira me të cilat përballemi në jetë.

Përveç pajisjes me fuqinë e vullnetit dhe aftësisë për të kontrolluar dëshirat, agjërimi rrënjësor brenda nesh një ndjenjë të thellë mirënjohjeje dhe durimi, ngase privimi nga diçka çon në vlerësimin e asaj gjëje. Pas një dite të gjatë agjërimi, shqisat tona të shijes dhe nuhatjes rriten. Çdo gllënjë uji është si një lum i freskët e i rrjedhshëm në një tokë të thatë e djerrë, dhe çdo kafshatë ushqimi që konsumohet është si të ushqesh një person që ka mbetur i bllokuar në një ishull të shkretë, duke pasur shumë pak për të ngrënë, pra na vjen si ushqimi më i shijshëm e më i lezetshëm. Është ajo që terapia Gestalt e definon si të qenët i përqendruar në përvojën e individit në momentin e tanishëm, të qenët i ndërgjegjshëm dhe të qenët aty në kohën e tanishme.

Në një botë të mbushur me kërkimin e realizimit të kënaqësive aty-për-aty, është shumë e shëndetshme të mësosh se si t'i vonosh kënaqësitë e thjeshta në jetë.

Të kesh durim për t'i bërë ballë tundimit dhe të jesh tolerant për kënaqësinë e vonuar, janë dy elementë shumë të rëndësishëm në arritjen e pjekurisë personale. Ne vetëm se jemi të trajnuar për të bërë durim në pritjen e qindra gjërave në jetë që kërkojnë kohë dhe vonohen pa paralajmërim.







Firman dhe Vargiu vunë në dukje se agjërimi gjithmonë ka qenë një metodë për të ndihmuar një individ të lëvizë drejt vetë-realizimit dhe të arrijë energji super-të-ndërgjegjshme. Së këndejmi, një periudhë e caktuar agjërimi mund të nxjerr në pah shkathtësi të jashtëzakonshme njerëzore, aftësi paranormale dhe gjendje të ndryshme të ndërgjegjes. Kjo shpjegon se pse ne jemi në gjendje të kryejmë sakrifica të tilla të larta shpirtërore gjatë Ramazanit, megjithëse jemi të privuar nga gjumi dhe abstenojmë nga ushqimi me një zell dhe kënaqësi të tillë.

Gjendja euforike që përjetojmë gjatë agjëritit mund të klasifikohet si një katarsis shpirtëror që përshkruan një pastrim që shëron dhe rikthen shpirtin. Është një dëbim, zbrazje dhe shkarkim i papastërtive brenda nesh, për të pastruar veten dhe për të na rilidhur me Allahun. Agjërimi mund të jetë një praktikë shpirtërore jashtëzakonisht transformuese (Len Sperring). Ai ofron mundësinë për t'u zgjidhur nga lidhjet tokësore, për t'u bashkuar me të shenjtën dhe për të krijuar ndjesi të një lidhje të thellë (hyjnore). Randi Fredricks deklaron se agjërimi ka fuqinë autentike për të ndryshuar individin, komunitetin, madje edhe botën.

Kur reflektojmë mbi implikimet psikologjike të agjëritit (ar. “savn”), atëherë fuqizohemi edhe më shumë për të përçafuar muajin e bekuar të Ramazanit dhe për t'u ngjitur në lartësi të reja shpirtërore me shpresën për të forcuar, pastruar dhe ndriçuar shpirtin.



## Përfitimet shëndetësore:

Ka shumë studime që vërtetojnë se agjërimi mund të kontribuojë në një shëndet më të mirë sesa të bësh një jetesë grykësore. Është thjesht një e vërtetë që njerëzimi e ka mësuar nga frymëzimi hyjnor, por edhe nga praktikat e tyre tradicionale të kujdesit ndaj shëndetit.

Transmetohet se Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: “I biri i Ademit nuk ka mbushur enë më të keqe sesa barkun e tij.” E, po ashtu, përmendet të ketë thënë: “Agjëroni shpesh për të qenë më të shëndetshëm!”

Prandaj, ai ﷺ i urdhëroi besimtarët të hanë vetëm me masë: “I mjafton birit të Ademit të hajë disa kafshata ushqim, aq sa ta mbajë kurrizin të qëndrueshëm. E, nëse vetja e tij e shtyn (të hajë më shumë), atëherë le ta ndajë barkun në tri pjesë: një të tretën për ushqim, një të tretën për ujë dhe një të tretën e mbetur për të marrë frymë (lirshëm)”. Këto janë të vërteta të mrekullueshme që janë testuar dhe provuar se janë receta perfekte për shëndetin dhe padyshim që konfirmojnë vërtetësinë e mesazhit hyjnor të Profetit ﷺ.

Kurani thotë:

**“Ai (Profeti) nuk flet nga tekat e tij, por ai është i frymëzuar nga Allahu.”** (Nexhm, 4)

Është kaq e mrekullueshme të dëgjosh këtë përfundim shkencor për efektin e agjërimin në shëndet. Kjo dëshmon se Profeti i Islamit është një i Dërguar i vërtetë i Allahut dhe ai ia ka përcjellë njerëzimit mesazhin e Allahut. Megjithatë, drejtësia e thënies profetike është vërtetuar shumë kohë më parë dhe ky përfundim shkencor është një konfirmim shtesë i deklaratës së tij.

Le ta forcojmë përkushtimin tonë ndaj kësaj feje të vërtetë duke ndjekur mësimet e saj që ishin të destinuara për interesin e njerëzimit.



## Rregullat dhe parakushtet

Në vitin e dytë të hixhretit (migrimit), muslimanët u urdhëruan që të agjërojnë çdo vit në muajin e Ramazanit. Kurani thotë:

**“O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të bëheni të devotshëm.”**  
(Bekare, 183)

Tutje Allahu i Lartësuar thotë:

**“Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja). Pra, kushdo nga ju që dëshmon këtë muaj, le të agjërojë!”**  
(Bekare, 185)

Profeti Muhamed ﷺ e shpjegoi këtë më tej në një numër hadithesh të transmetuara në librat e Hadithit. Transmetohet nga Imam Buhariu dhe Imam Muslimi nga Ibn Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë:





**“Islami është ngritur mbi pesë shtylla: Mbi dëshminë se s'ka të adhuruar të denjë përveç Allahut dhe se Muhamedi ﷺ është i Dërguari i Tij, faljen e namazit, dhënien e zekatit, kryerjen e haxhit dhe agjërimin e Ramazanit.”**

Umeti Islam është unanimitet se agjërimi i muajit të Ramazanit është obligim për çdo person që është mukel-lef (i aftë).

### **Mbi kë bie obligimi i agjërimin:**

Agjërimi i muajit të Ramazanit është i detyrueshëm për çdo musliman, mashkull apo femër, i cili është i rritur (d.m.th. ka arritur pubertetin) dhe me mendje të shëndoshë, si dhe që nuk është i sëmurë apo në udhëtim.

Sëmundja mund të jetë një sëmundje e përkohshme nga e cila pret të shërohet së shpejti. Një person i tillë lejohet të mos agjërojë gjatë ditëve të sëmundjes, por duhet të agjërojë më vonë pas Ramazanit për të plotësuar ditët e humbura. Ata që janë të sëmurë me sëmundje të pashërueshme dhe nuk presin shëndet më të mirë, të tillëve u lejohet gjithashtu të mos agjërojnë (pa zëvendësim), por duhet të paguajnë fidjen (kompensimin), që është dhënia e shujtave të një dite një nevojtar, për çdo ditë të humbur të agjërimin.





Gjithashtu, në vend të shujtave mund t'i paguhet edhe me para një nevojtar.

Gratë në menstruacione dhe gjakderdhje pas lindjes nuk lejohen të agjërojnë, por ato duhet të kompensojnë pas Ramazanit ditët e humbura. Gratë shtatzëna dhe nënat që ushqejnë foshnjat në gji, nëse e kanë të vështirë të agjërojnë, mund ta shtyjnë agjërimin për një kohë të mëvonshme kur janë në gjendje më të mirë.

Udhëtim, sipas Sheriatit, quhet çdo udhëtim që ju largon nga qyteti juaj i banimit, të paktën 80 kilometra. Udhëtimi i këtillë na lejon edhe të bëjmë kasr (shkurtim të namazit) dhe bashkim. Udhëtimi duhet të jetë për një arsye të ligjshme. Gjithashtu, është mëkat të udhëtosh në Ramazan për të shmangur agjërimin.

Një musliman duhet të përpiqet të ndryshojë planet e tij/saj gjatë Ramazanit për të qenë në gjendje të agjërojë dhe nuk duhet të udhëtojë nëse nuk është e nevojshme. Udhëtari që i humb agjërimet e Ramazanit duhet t'i kompensojë ato ditë të humbura pas Ramazanit sa më shpejt që të jetë e mundur.

### **Mënyra e kryerjes së agjërimin:**

- 1 - Bëni syfyr (shujtë para agimit). Ngrënia e syfyrin është traditë profetike (sunset) dhe ka shpërblim dhe bekim të madh në të. Koha më e mirë për syfyr është gjysma e fundit para agimit ose koha para namazit të sabahut.
- 2 - Bëni iftar (prishje të agjërimin) menjëherë pas perëndimit të diellit. Sheriati e konsideron perëndim të diellit kohën kur disku i diellit shkon prapa horizontit dhe zhduket plotësisht.
- 3 - Gjatë agjërimin largohuni nga të gjitha bisedat e kota dhe gënjeshttrat. Mos u grindni, mos keni mosmarrëveshje, mos u zhytni në debate, mos përdorni fjalë të këqija dhe mos bëni ndonjë gjë që është e ndaluar. Njeriu duhet të përpiqet të disiplinojë veten moralisht dhe etikisht, përveç trajnimit fizik dhe disiplinës që e fiton gjatë këtij muaji. Njeriu gjithashtu nuk duhet të tregojë agjërimin e tij duke folur shumë për të, ose duke treguar buzët e thata dhe stomakun e uritur, ose duke shfaqur temperament të keq. Agjëruesi duhet të jetë një person i këndshëm, me shpirt të mirë dhe me humor të mirë.



Gjatë agjërimit njeriu duhet të bëjë vepra bamirësie dhe të mira ndaj të tjerëve dhe duhet të shtojë adhurimin dhe leximin e Kuranit. Çdo musliman duhet të përpiqet të lexojë të gjithë Kuranin të paktën një herë gjatë muajit të Ramazanit.

### **Gjërat që e prishin agjërimit:**

Njeriu duhet të shmangë çdo gjë që mund ta bëjë të pavlefshëm agjërimit e tij. Gjërat që e prishin agjërimit dhe kërkojnë kaza (zëvendësim të këtyre ditëve) janë këto:

- 1 - Ngrënia dhe pirja me qëllim, duke përfshirë edhe marrjen e çdo sendi jo-ushqyes përmes gojës, hundës ose anusit.
- 2 - Të vjella me dashje.
- 3 - Fillimi i gjakderdhjes menstruale apo të pas-lindjes, qoftë edhe në momentin e fundit para perëndimit të diellit.
- 4 - Ejakulimi si pasojë e ndonjë nxitje seksuale.
- 5 - Ngrënia, pirja ose kryerja e marrëdhënieve seksuale pas sabahut (agimit), si pasojë e vlerësimit të gabuar të kohës, duke menduar se ende nuk ka hyrë koha e sabahut. E njëjta gjë vlen për gjërat e lartcekura edhe në kohën para perëndimit të diellit, duke menduar se tashmë dielli ka perënduar.



Sa i përket marrëdhënies seksuale gjatë agjërimit, është e ndaluar dhe është mëkat i madh. Ata që e veprojnë atë duhet t'i bëjnë dy gjëra: kaza' dhe kefaret (shlyerje, duke agjëruar 60 ditë rresht pas Ramazanit, ose (nëse nuk ka mundësi) duke ushqyer 60 të varfër, për çdo ditë agjërimit të prishur në këtë mënyrë).

Ndërkaq, sipas Imam Ebu Hanifes, edhe ngrënia dhe/ose pirja e qëllimshme gjatë agjërimit përfshin të njëjtën kaza' dhe kefaret.

### **Gjërat e lejuara gjatë agjërimit:**

Gjatë agjërimit lejohen këto gjëra:

- 1**- Të bësh banjë ose dush. Nëse uji gëlltitet në mënyrë të pavullnetshme nuk e prish agjërimitin. Sipas shumicës së juristëve, noti lejohet edhe në agjërimit, por duhet shmangur zhytja, sepse kjo mund të bëjë që uji të shkojë nga goja ose hunda në stomak.
- 2**- Përdorimi i parfumeve, vendosja e lenteve të kontaktit ose përdorimi i pikave për sy.
- 3**- Marrja e injeksioneve ose kryerja e analizave të gjakut.
- 4**- Përdorimi i misvakut (shkopit të arakut) ose furçës së dhëmbëve (edhe me pastë dhëmbësh), si dhe shpëlarja e gojës ose e vrimave të hundës me ujë, me kusht që të mos teprohet (për të shmangur gëlltitjen e ujit).
- 5**- Ngrënia dhe pirja pa dashje, d.m.th. duke harruar se është agjërueshëm. Por njeriu duhet të ndalet sapo t'i kujtohet dhe duhet të vazhdojë agjërimitin.



**6** - Nëse njeriu fle gjatë ditës dhe laget nga ëndrrat, nuk e prish agjërimin. Gjithashtu, nëse dikush kryen marrëdhënie gjatë natës dhe nuk ka mundur të bëjë gusl (të lahet) para agimit, ai/ajo mund të fillojë të agjërojë dhe të bëjë gusl më vonë (për ta falur sabahun). Gratë të cilave u ndalen menstruacionet gjatë natës mund të fillojnë të agjërojnë edhe nëse nuk kanë bërë gusl ende. Në të gjitha këto raste, gusli (larja e trupit në tërësi) është i domosdoshëm, por agjërimi vlen edhe pa u larë.

**7** - Puthja ndërmjet burrit dhe gruas lejohet në agjërim, por duhet të përpiqet t'i shmanget asaj, që të mos nxitet të bëjë diçka më shumë, e që është e ndaluar gjatë agjërimit.

### **Parakushtet për vlefshmërinë e agjërimit:**

Në thelb ekzistojnë dy komponentë kryesorë të agjërimit:

**1** - Nijeti (qëllimi) për agjërim. Njeriu duhet të bëjë nijet të sinqertë për të agjëruar për hir të Allahut çdo ditë para agimit. Qëllimi nuk duhet të jetë me fjalë, por duhet të jetë me sinqeritetin e zemrës dhe mendjes. Disa juristë janë të mendimit se nijeti mund të bëhet vetëm një herë për të gjithë muajin dhe nuk ka pse të përsëritet çdo ditë. Megjithatë, është më mirë të bësh nijet çdo ditë për të përfituar plotësisht nga agjërimi.

**2** - Të përmbaheni nga agimi deri në muzg nga çdo gjë që e prish agjërimin. Kjo pikë është shpjeguar në detaje në paragrafët e mëparshëm.






### **Prishja e disa ditëve të agjërimit të Ramazanit pa arsye:**

Dihet përgjithësisht se asnjë ditë nuk është e barabartë me ditët e Ramazanit, përveç ditëve të një Ramazani tjetër. Në të njëjtën kohë, të gjitha ditët e Ramazanit janë fillimisht ditë agjërimi, kështu që nuk mund të kompensohet asnjëherë agjërimi i humbur i Ramazanit gjatë një Ramazani tjetër.

Për këtë arsye Ebu Hurejra ka thënë: “Kush nuk e ka agjëruar një ditë të Ramazanit, pa arsye shariatike ose pa ndonjë pasur ndonjë sëmundjeje, nuk mund ta kompensojë asnjëherë”. (Tirmidhiu, Ebu Davudi, Nesaiu, Ibn Maxhe)

Kefareti: Agjërimi i muajit të Ramazanit është farz (obligim) për çdo musliman të rritur që nuk është i sëmurë apo në udhëtim. Është mëkat të humbasësh agjërimitin e Ramazanit pa arsye. Profeti (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Kushdo që e prish qoftë edhe një ditë agjërimit të Ramazanit pa arsye ose sëmundje, edhe nëse ka agjëruar tërë jetën pas kësaj, nuk do t'ia kompensojë atë që ka humbur". (Tirmidhiu)

Por, nëse tashmë jeni penduar për pakujdesinë tuaj, ju sugjeroj të pendoheni sinqerisht dhe të kërkonit falje nga Allahu, se Allahu ka premtuar se nëse dikush pendohet sinqerisht, Allahu ia pranon pendimin dhe e falë atë.





Ju gjithashtu duhet të përpiqeni të kompensoni ditët e humbura. Llogaritni sa ditë të Ramazanit keni humbur. Kompensoni ato ditë duke agjëruar një ditë për çdo ditë që keni humbur.

Nëse jeni prej atyre që s'keni mundësi të agjëroni, atëherë jepni kefaret, që nënkupton shujtat e një dite, ose vlera e kësaj, për t'i dhënë një personi në nevojë, gjë të cilën e vlerësojmë përafërsisht dhjetë dollarë në ditë për çdo ditë të agjërimit.

Kështu, duke bërë këto vepra, mund të mos jeni në gjendje t'i kompensoni plotësisht ditët e munguara të Ramazanit, por të paktën do të shprehni pendimin dhe përpjekjen tuaj të sinqertë për të përmbushur urdhrat e Allahut.





## Gratë në Ramazan


Gratë muslimane, si gjithë të tjerët, kanë pritshmëri të mëdha për muajin e bekuar, si dhe më shumë ngarkesa dhe detyra.

Arritja e asaj që dëshironi në Ramazan është e lidhur ngushtë me menaxhimin e kohës dhe planifikimin realist.

Gratë kanë më shumë detyra në Ramazan, veçanërisht nëse janë edhe në punë, megjithatë, ato ende kanë disa mundësi për të marrë shpërblime, gjë që e bën edhe më të rëndësishme për to organizimin dhe koordinimin e shumëllojshmërisë së aktiviteteve vetëm gjatë një muaji.

Bamirësia është një derë gjerësisht e hapur në të cilën gratë mund të marrin pjesë në mënyra të ndryshme: gatimi i ushqimit për njerëzit në nevojë, mbledhja e parave nga të afërmit dhe miqtë për arsye bamirësie, ... këto janë vetëm disa.

Gratë kanë gjithashtu një rol shumë të rëndësishëm dhe vendimtar për t'i ndihmuar fëmijët e tyre të kuptojnë se çfarë është Ramazani dhe në organizimin e aktiviteteve argëtuese që lidhen me muajin e shenjtë.





### **Kompensimi i ditëve të humbura të Ramazanit:**

Është e rëndësishme që gruaja të kompensojë sa më parë agjërimet e humbura; ajo mund t'i bëjë ato radhazi ose t'i ndajë, por duhet t'i përfundojë para Ramazanit të ardhshëm.

Aishja, gruaja e dashur e Profetit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!), ka thënë: "Më mbeteshin ditë Ramazani për t'i kompensuar, të cilat nuk mund t'i kompensoja vetëm se në shaban (në prag të Ramazanit të ardhshëm)." (Buhariu)

Megjithatë, çështja ka qenë e diskutueshme mes studiuesve: një grup këmbëngul se kompensimi i ditëve të humbura të agjërimit duhet të bëhet në vijimësi (pas Ramazanit); kjo do të ishte e vërtetë, veçanërisht nëse dikush do t'i ketë humbur të gjitha përnjëherësh.

Grupi i dytë thotë se mund të bëhet në mënyrë të njëpasnjëshme ose me pauza, sepse Allahu thotë:

**“Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja). Pra, kushdo nga ju që dëshmon këtë muaj, le të agjërojë! Sa i përket atij që është i sëmurë ose gjendet në udhëtim e sipër (le të agjërojë më vonë) aq ditë sa nuk i ka agjëruar. Allahu dëshiron që t’jua lehtësojë dhe jo që t’jua vështirësojë. Ai dëshiron që të plotësoni numrin e ditëve të agjërimit dhe që ta madhëroni Allahun (në fund të agjërimit), për shkak se ju ka drejtuar në rrugë të drejtë e që ta falënderoni Atë.” (Bekare, 185)**

Si përfundim, gruaja duhet të shpejtojë për të kompensuar agjërimet e saj të humbura dhe këtë duhet ta bëjë para ardhjes së Ramazanit vijues.



### **Hixhabi, namazi dhe agjërimi**

Nëse kryhet një akt adhurimi, shpresohet që Allahu ta pranojë atë përderisa bëhet për hir të Tij. Mirëpo, nuk duhet të jemi të sigurt për pranimin e tij, pasi kjo çështje kthehet tek Allahu, i Cili thotë në Kuran: "**Vërtet, Allahu pranon vetëm prej të devotshmëve.**" (Maide, 27)

Për sa u përket besimtarëve që bëjnë disa mëkate, Allahu nuk do t'i privojë ata nga shpërblimi i veprave të tyre të mira. Ai thotë: "**Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë.**" (Zelzele: 7, 8)  
Kështu, sa i përket gruas që nuk mban hixhab, por fal namazin dhe agjëron Ramazanin, ibadetet e saj shpresohet të pranohen. Megjithatë, ajo do të dënohet për mosvënien e hixhabit, pasi që një vepër e tillë është mëkat.

Besimtari nuk duhet të mbështetet krejtësisht në mëshirën dhe faljen e Allahut duke mos iu frikësuar Allahut dhe duke vazhduar të bëjë mëkate. Përkundrazi, besimtari që ka bërë një mëkat është i detyruar të pendohet dhe të kërkojë falje nga Allahu dhe të mos e bëjë mëkatin që Allahu ta falë. Allahu thotë: "**Vërtet, Unë jam Falës për atë që pendohet, beson e bën vepra të mira dhe pastaj qëndron në rrugë të drejtë.**" (Ta-Ha, 82)

Mosvënia e hixhabit është shenjë e mosfrikës nga ndëshkimi i Allahut, sepse nëse ajo do t'i frikësohej Allahut, do t'u përmbahej urdhrave të Tij. Pra, si e pranon Allahu namazin dhe agjërimin e atij që nuk i frikësohet Atij?



Duhet të jetë e qartë se ka dallim ndërmjet vlefshmërisë së një akti adhurimi dhe pranimit të tij. Namazi dhe agjërimi i dikujt mund të jenë të vlefshme përderisa plotësohen kushtet e namazit dhe agjërimit, dhe nuk mund të themi se janë të pavlefshme, pasi nuk ka asnjë lidhje midis vlefshmërisë dhe pranimit të tyre nga Allahu. Por, vetëm po themi se pranimi i tyre është krejtësisht kompetencë e Allahut.

## **A i lejohet një gruaje të marrë pilula për të ndaluar menstruacionet gjatë Ramazanit?**

Nuk ka asgjë të keqe, për sa i përket Islamit, nëse një grua merr pilula të tilla gjatë Ramazanit, në mënyrë që të mund të vazhdojë të agjërojë tërë muajin e bekuar pa ndërprerje.

Megjithatë, duhet të kemi parasysh se gruas i lejohet të bëjë një gjë të tillë në përputhje me kushtet e mëposhtme:

- 1** - Marrja e këtyre pilulave nuk duhet të rezultojë në rrezikimin e jetës dhe shëndetit të saj.
- 2** - Është më mirë, përpara se të merrni një mjekim të tillë, të kërkonti këshillën e një mjeku të besueshëm. Pra, sa i përket të moshuarit dhe të moshuarës, si dhe të sëmurit që nuk pret shërim nga sëmundja, ata nuk duhet të agjërojnë, dhe si lëmoshë duhet të ushqejnë një të varfër për çdo ditë.

### **Gruaja e moshuar dhe shtatzënë në agjërim:**

Sa i përket gruas shtatzënë ose nënës gjidhënëse, nëse ajo shqetësohet se mos e dëmton agjërimi, shumica e juristëve janë të mendimit se asaj i lejohet të mos agjërojë, me kusht që t'i kompensojë ditët e agjërimit që i ka lënë. Ngase në këto raste gruaja i ngjason një pacienteje.



Ndonëse dijetarët kanë rënë dakord unanimisht se një gruaje shtatzënë ose gjdhënëse, e cila mund t'i shkaktojë dëme embrionit të saj ose fëmijës së saj të porsalindur, i lejohej të mos agjërojë, ata nuk janë pajtuar nëse ajo duhet t'i kompensojë ditët e agjërit që ka humbur më vonë, apo të ushqejë një të varfër për çdo ditë që ka humbur, apo t'i veproja të dyja këto.

### **Kategoritë e muslimanëve në Ramazan:**

Në Ramazan, muslimanët mund të kategorizohen në një nga grupet në vijim.

Së pari, ka nga ata që e presin këtë muaj me durim, të lumtur për ardhjen e tij, kështu që i sheh ata duke punuar me zell në ibadete të ndryshme, duke kryer atë që është e detyrueshme dhe duke kryer ibadete të shumta mustehab (vullnetare). Ata e bëjnë këtë duke ndjekur gjurmët e më të mirit të njerëzimit, Muhamedit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!), siç është transmetuar në Sahih El-Buhari.

Pastaj janë ata njerëz që hyjnë në këtë muaj dhe dalin në të njëjtën gjendje siç kanë hyrë, pra pa ndonjë shtim të veprave të mira. Në të vërtetë, individët e këtij grupi kanë humbur një numër të madh dhe të panumërt të veprave të mira.

Grupi i tretë i njerëzve janë ata që nuk merren me adhurim përveçse në këtë muaj. Këta njerëz quhen adhurues të Ramazanit. Kur vjen muaji i Ramazanit, i sheh të tillët duke prezantuar në xhami. Megjithatë, sapo muaji të mbarojë, ata kthehen në gjendjen e tyre të vjetër. Individit të kësaj kategorie ne i themi, ju duhet të vazhdoni bindjen ndaj Allahut në muajt e tjerë ashtu siç keni qenë në Ramazan, në mënyrë që ta takoni Allahun në një gjendje që e kënaq Atë.

Grupi tjetër i njerëzve janë ata që agjërojnë duke u përmbajtur nga ushqimi dhe pijet, por jo edhe nga punët tjera (të këqija), pra nuk u paraprijnë veprave të këqija me të mira. E vetmja gjë që këta njerëz arrijnë nga agjërimi i tyre është uria dhe etja, siç na informon Profeti ﷺ.



Një grup tjetër njerëzish janë ata që ditët e Ramazanit i shndërrojnë në kohë gjumi dhe netët e tij në kohë argëtimi. Ata nuk i kalojnë ditët dhe netët duke përmendur Allahun, por netët i kalojnë me argëtim. Këtyre njerëzve ne u themi, kini frikë Allahun dhe mos u privoni nga angazhimi me vepra të mira për shkak të mirësive që ju janë dhuruar nga Allahu.

Grupi i fundit i njerëzve përfshin ata që nuk e njohin Allahun e Lartësuar as në Ramazan, as jashtë tij. Ju i gjeni këta individë të pavëmendshëm në lidhje me namazin dhe agjërimin e tyre. Ata i braktisin këto shtylla, pavarësisht se janë të pajisur me shëndet të shkëlqyer, e, shkuar kësaj, kanë guximin edhe të deklarojnë se besojnë.








## Itikafi (qëndrimi në xhami)

Bërja e itikafit në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit në xhami është një veprim i bukur nga Suneti i Profetit (paqja qoftë mbi të!). Është një përkushtim shpirtëror.

Transmetohet nga Aishja se Profeti (paqja qoftë mbi të) bënte itikaf gjatë dhjetë ditëve të fundit të muajit të Ramazanit dhe ai vazhdoi këtë praktikë derisa ndërroi jetë. Pastaj, gratë e tij vazhduan t'i përmbahen kësaj praktike rregullisht pas vdekjes së tij. (Buhariu dhe Muslimi).

Rekomandohet që çdo musliman të bëjë të paktën një itikaf në jetën e tij. Myslimanët duhet të jenë të etur për ta kryer këtë vepër të Sunetit në çdo komunitet, për ta mbajtur atë të gjallë në mesin tonë. Edhe gratë mund të bëjnë itikaf, por është më mirë për to të jenë në shtëpi, për shkak të ruajtjes së modestisë. Së këndejmi, itikaf përmban në vete bekime dhe shpërblime të mëdha që duhet të synohen nga çdonjëri.

Itikafi bëhet duke pasur për qëllim që për hir të Allahut të qëndrohet në xhami (për adhurim). Është e pëlqyeshme që itikafi të fillohet nga mbrëmja e ditës së 20 (njëzetë) të Ramazanit, e deri në fund të muajit. Gjatë itikafit njeriu duhet të qëndrojë gjatë gjithë kohës në xhami dhe nuk lejohet të largohet prej saj, përveçse për ndonjë domosdoshmëri ose nevojë, si p.sh. të shkuarit në tualet.





Gjatë itikafit njeriu duhet ta kalojë kohën e tij në namaz, duke lexuar Kuran, duke bërë dhikër dhe duke reflektuar/medituar.

Angazhimi në biznes dhe biseda dhe aktivitete të tjera të kësaj bote nuk lejohet gjatë itikafit.

Megjithatë, lejohet të marrësh pjesë në përcjelljen e xhenazes ose të vizitosh një person të sëmurë ose të largohesh për ndonjë emergjencë.






## Nata e Kadrit

Shprehja nata e Kadrit në fakt do të thotë "Nata e Fuqisë" ose "Nata e Përcaktimit". Kjo ishte nata në të cilën Kurani zbriti nga El-Levh El-Mahfudh (Pllaka e Ruajtur) në qiellin e parë. Allahu i Madhëruar thotë:

**“Ne e kemi zbritur (Kuranin) në Natën e Kadrit. E kush mund të ta shpjegojë ty se ç’është nata e Kadrit? Nata e Kadrit është më e mirë se një mijë muaj. Engjëjt dhe Shpirti (Xhebraili), me lejen e Zotit të tyre, zbresin në këtë natë, me të gjitha vendimet (përcaktimet). Paqe është ajo deri në lindjen e agimit.”** (Kadr, 1-5)

Ibn Kethiri komentoi frazën: **“Engjëjt dhe Shpirti ...”** duke thënë: “Kjo do të thotë se zbritja e engjëjve shtohet gjatë kësaj nate, për shkak të sasisë së madhe të bekimeve të saj. Dhe, engjëjt zbresin së bashku me zbritjen e bekimit dhe mëshirës.”






Kjo natë ndodh vetëm në Ramazan, pasi në të është shpallur Kurani: **“Vërtet, Ne e zbritëm atë (Kuranin) në Natën e Kadrit.”** Transmeton Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se Profeti ﷺ ka thënë: **“Ju ka ardhur juve Ramazani, muaj i bekuar. Allahu e ka bërë detyrë për ju agjërimin e tij. Në të hapen dyert e Xhenetit, dyert e Xhehenemit mbyllen dhe shejtanët lidhen me zinxhirë. në të gjendet një natë e cila është më e mirë se një mijë muaj. Kushdo që pengohet nga e mira e saj, atëherë ai është privuar.”** (Ahmedi, Nesaiu dhe Bejhakiu)

Pra, ai që e humb Natën e Kadrit, është me të vërtetë një person shumë fatkeq! Kjo është arsyeja pse Nata e Kadrit është kaq e veçantë për adhuruesit, të cilët përpiqen shumë për të fituar bekimet e saj.

Ebu Hurejra transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Kush falet në Natën e Kadrit, duke besuar dhe shpresuar në shpërblimin e Allahut, do t'i falen mëkatet e kaluara.”** (Buhariu)

Çdo besimtar i sinqertë është i etur për të falur namazin gjatë Natës së Kadrit, duke kërkuar faljen e mëkateve, si dhe shpërblimet e mëdha nga Allahu. Hadithet e cituara më sipër janë dëshmi për vlerën e natës së Kadrit, si dhe për kryerjen e namazit të natës gjatë saj.

Gjithashtu tregohet qartë se Allahu e ka nderuar këtë natë dhe e ka bërë më të mirë se një mijë muaj, që është e barabartë me tetëdhjetë e tre vjet e katër muaj!





Për këtë arsye, kushdo që fal namazin e natës, me besim të vërtetë dhe duke kërkuar shpërblimin e Allahut në të, do të jetë i falur nga Allahu. Pra, ne duhet të jemi të etur për t'i fituar këto shpërblime duke kryer namaz nate e lutje, qoftë në xhami, qoftë në shtëpi, gjatë asaj nate.

Në lidhje me faljen me xhemat, Profeti ﷺ ka thënë: “Kushdo që qëndron në namaz me imamin derisa ai (imami) ta përfundojë namazin, atij i shënohet sikur të kishte kaluar tërë natën në namaz”. (Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe)

Rekomandohet që gjatë kësaj nate të bëhet shumë lutje, siç transmeton Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se Profeti ﷺ ka rekomanduar një lutje të veçantë në këtë natë:

**"Allahume, ineke afuvun, tuhibul afva, fe-afuani." (O Allah, Ti je Ai që fal shumë dhe e do faljen, prandaj më fal mua!)**

Po ashtu, dijetarët kanë përmendur se qëllimi i tikafit në Ramazan është kërkitimi i bekimeve dhe shpërblimeve në natën e Kadrit.



## Kur është nata e Kadrit?

Ibn Abasi transmeton se Profeti (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

**“Kërkojeni atë në dhjetëshen e fundit të Ramazanit; kërkojeni në të nëntën, në të shtatën dhe në të pestën.” (përkatësisht netët 21, 23, 25).** (Buhariu)

Pra, preferohet ta kërkojmë Natën e Kadrit në netët tek të dhjetë ditëve të fundit të Ramazanit: natën e njëzet e një, të njëzet e tretë, të njëzet e pestë, të njëzet e shtatë dhe të njëzet e nëntë.

Nëse dikush është shumë i dobët ose i paaftë për ta kërkuar atë në të gjitha netët tek, atëherë le ta kërkojmë atë në netët e fundit tek: natën e njëzet e pestë, të njëzet e shtatë dhe të njëzet e nëntë.





## Bajrami i Fitrit


Bajrami i Fitrit është dita e begatisë dhe bekimeve për të gjithë muslimanët agjërues, pasi atyre u është premtuar një shpërblim i madh nga Allahu i Plotfuqishëm për agjërimin e tyre me përkushtim.

Në fund të Ramazanit, muslimanët shprehin mirënjohjen e tyre ndaj Allahut, i cili ua mundësoi agjërimin dhe në të njëjtën kohë u dhuroi furnizim të bollshëm gjatë këtij muaji të bekuar.

Prandaj, Bajrami i Fitrit është ditë gëzimi, adhurimi, falënderimi ndaj Allahut, bashkëpunimi, solidariteti, vëllazërimi, bashkimi dhe furnizimi shpirtëror.

**Rëndësia:** Në përfundim të muajit të Ramazanit, në ditën e parë të muajit të 10-të të kalendarit hënor islamik, bie Bajrami i Fitrit. Kjo është një nga dy festat kryesore të Islamit dhe festohet nga të gjithë muslimanët në mbarë botën. Namazi i Bajramit falet herët në mëngjes me xhemat.

Namazi duhet të kryhet në një vend të madh të hapur ku marrin pjesë të gjithë muslimanët, meshkuj apo femra. Pas namazit, imami mban një hutbe të shkurtër dhe më pas njerëzit përshëndesin njëri-tjetrin. Pjesa tjetër e ceremonive zakonisht mbahen privatisht me familjarët dhe miqtë.





Rëndësia e Fitër Bajramit është se është ditë falënderimi ndaj Allahut që u dha mundësinë muslimanëve të përfitojnë dhe të gëzojnë bekimet e muajit të Ramazanit.


### **Rregullat:**

#### **1** - Falja e namazit të Bajramit

Disa nga dijetarët thonë se namazi i Bajramit është vaxhib (obligativ). Ky është mendimi i dijetarëve hanefi dhe shejhul Islam Ibn Tejmijes. Disa dijetarë thonë se namazi i Bajramit është farz kifaje (obligim kolektiv). Ky është mendimi i hanbelive. Sakaq grupi i tretë thotë se namazi i Bajramit është sunet mu'eked (sunet i fortë). Ky është mendimi i malikive dhe shafijve.

#### **2** - Falja e namazeve vullnetare

Nuk ka namaze vullnetare për të falur as para, as pas namazit të Bajramit. Ibn Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ditën e Bajramit dilte dhe falte dy rekate (si imam), pa falur gjë para ose pas tyre. Ky është rasti nëse namazi falet në një zonë të hapur.







Megjithatë, nëse njerëzit e falin namazin e Bajramit në një xhami, atëherë ata duhet të falin dy rekate te hijet ul-mesxhid (përshëndetëse për xhaminë).

### 3 - Gratë që marrin pjesë në namazin e Bajramit

Sipas Sunetit të Profetit ﷺ, meshkujt dhe femrat muslimane nxiten të marrin pjesë në namazin e Bajramit, për të dëshmuar mirësinë e kësaj dite, madje edhe femrave me menstruacione u kërkohet të marrin pjesë në namazin dhe hutben e Bajramit, por ato duhet të qëndrojnë pak më larg vendit të namazit. Do të thotë, ato vijnë të dëgjojnë hutben e Bajramit dhe të ndajnë lumturinë me muslimanët, por pa e falur namazin, pasi kjo u ndalohej atyre. Gjithashtu, gratë këshillohen të jenë të veshura siç duhet dhe të mos qesin parfume, sepse kjo është në kundërshtim me udhëzimet e Profetit ﷺ për gratë.

### 4 - Agjërimi

Agjërimi gjatë ditëve të Bajramit është i ndaluar (haram), për shkak të hadithit të Ebu Seid Hudriut (Allahu qoftë i kënaqur me të!) në të cilin ai ka thënë se i Dërguari i Allahut ﷺ e ka ndaluar agjërimin e ditës së Bajramit të Fitrit dhe Bajramit të Kurbanit. (Muslimi)

## Etiketat e Bajramit

### 1 - Gusli (larja e plotë):

Një nga veprat e mira të Bajramit është të lahesh para se të dalësh për namaz. Është transmetuar se Seid ibn Xhubejri ka thënë: “Tri gjëra janë sunet në Bajram: të ecësh (për në vendin e namazit), të bësh banjë dhe të hash diçka para daljes (nëse është Bajrami i Fitrit).”



## 2- Të ngrënit para daljes:

Nuk duhet dalë në namazgja (vendin e namazit) ku falet Bajrami i Fitrit para se të hajë disa hurma, për shkak të hadithit të transmetuar nga Buhariu se Enes ibn Maliku ka thënë: “I Dërguari i Allahut ﷺ nuk dilte (nga shtëpia) në mëngjesin e Bajramit të Fitrit, pa ngrënë disa hurma... dhe hante numër tek të hurmave”. Kurse në Bajramin e Kurbanit, është mustehab (e pëlqyeshme) që të mos hahet deri pas namazit, kur personi ha nga mishi i kurbanit.

## 3- Tekbiri (thënia “Allahu Ekber”) në ditët e Bajramit:

Ky është një nga sunetet më të mëdha të kësaj dite. Derakutniu dhe të tjerët kanë transmetuar se kur Ibn Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) dilte për Bajramin e Fitrit ose Kurbanit, ai vazhdimisht bënte tekbiere derisa arrinte në namazgja, pastaj vazhdonte të bënte tekbir derisa të vinte imami.

## 4- Përgëzimi i njëri-tjetrit:

Njerëzit duhet të shkëmbejnë urime dhe përshëndetje për Bajramin, pavarësisht se çfarë shprehje urimi përdorin. Për shembull, ata mund t'i thonë njëri-tjetrit “Tekabbel Allahu minaa ve minke (Allahu i pranofte prej nesh dhe prej jush veprat tona të mira!)”. Xhubejr ibn Nufejri ka thënë: “Në kohën e Profetit ﷺ, kur njerëzit takoheshin me njëri-tjetrin në ditën e Bajramit, thoshin: “Tekabbel Allahu minaa ve minke”. (Ibn Haxheri)

## 5- Veshja e rrobave më të mira për Bajram:

Xhabiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: “Profeti kishte një xhube (mantel) që e vishte për Bajram dhe për Xhuma”. Bejhakiu transmeton se Ibn Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) vishte rrobat e tij më të mira për Bajram. Pra, burrat duhet të veshin rrobat më të mira që kanë kur dalin për Bajram.



**6** - Ndërrimi i rrugës gjatë kthimit nga vendi i namazit: Xhabir ibn Abdullahu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Pejgamberi ﷺ mernte rrugë të ndryshme ditën e Bajramit (gjatë shkuarjes dhe gjatë kthimit nga namazi i Bajramit). (Buhariu)





## Mësimet që marrim nga agjërimi

Allahu i Lartësuar thotë:

**“Qoftë i lartësuar Ai, në dorën e të Cilit është pushteti suprem dhe që është i Fuqishëm të bëjë çdo gjë! Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t’ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë; Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i madh.”**

(Mulk, 1-2)

Gjithashtu Ai thotë:

**“Ai krijoi natën dhe ditën që të vijnë njëra pas tjetrës, si këshillë për ata që duan ta kujtojnë ose duan ta falënderojnë.”**

(Furkan, 62)

Jeta dhe vdekja, si dhe vazhdimësia e netëve dhe ditëve, kanë një qëllim, e ai është të na sprovujë dhe të na japë mundësinë për të shprehur falënderimet dhe mirënjohjen tonë ndaj Krijuesit dhe Furnizuesit tonë. Muaji i Ramazanit vjen e shkon. Ne duhet të rishikojmë vetveten tani dhe të shohim se çfarë kemi mësuar dhe arritur gjatë këtij muaji. Testi i suksesit të këtij muaji qëndron në efektet që ka lënë tek ne, siç vijojnë:





### 1 - Disiplina:

Në këtë muaj ne mësojmë se si të disiplinojmë veten për hir të Allahut. Në mëngjes dhe në mbrëmje, ne ndjekim një orar të rreptë të ngrënies dhe pirjes. Ne jemi vazhdimisht të vetëdijshëm se edhe në aktivitetet tona të zakonshme si ngrënia dhe pirja, ne duhet të qëndrojmë nën urdhrat hyjnor. Ne mund t'i ndryshojmë zakonet tona në rutinën tonë të përditshme, sepse mësojmë se nuk jemi shërbëtorë dhe skllëvër të zakoneve tona, por gjithmonë shërbëtorë të Allahut. Pastaj pas Ramazanit, ne duhet ta mbajmë këtë frymë discipline në mënyrat e tjera të jetës sonë dhe duhet të vazhdojmë me nënshtrimin tonë ndaj urdhrave të Allahut.

### 2 - Përtëritja e devotshmërisë:

Ramazani na ripërtërin entuziazmin për adhurim dhe përkushtim ndaj Allahut. Në këtë muaj ne jemi më të kujdesshëm ndaj lutjeve tona të përditshme dhe kemi lutje të veçanta gjatë natës. Nuk ka fe pa lutje dhe muslimanët mësojnë në këtë muaj se si ta forcojnë dhe thellojnë përkushtimin e tyre fetar.

### 3 - Përtëritja e lidhjes me Kuranin:

Ramazani dhe Kurani janë të lidhur që nga fillimi. Ishte në këtë muaj që ky mesazh hyjnor iu shpall Profetit Muhamed (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!). Na është transmetuar se Profeti ﷺ ishte duke agjëruar kur mori shpalljen e parë. Agjërimi i përgatit zemrat e besimtarëve për të mësuar Fjalën e Allahut. Është kushti më i përshtatshëm për komunikimin tonë shpirtëror dhe mendor me Kuranin.



Umeti musliman i kushton shumë vëmendje Kuranit në këtë muaj. Ky kontakt i ripërtërirë me Kuranin duhet të na ndihmojë në ndjekjen e mesazhit të tij.

#### **4 - Përtëritja e identitetit tonë karshi Umetit:**

Ramazani nuk është vetëm një përvojë individuale, por është një përvojë e komunitetit. I gjithë umeti musliman agjëron së bashku në të njëjtin muaj. Ne identifikohemi me njëri-tjetrin në bindjen tonë ndaj Allahut. Kjo na jep një ndjenjë të re bashkimi dhe shoqërimi.

Ramazani na mëson se Umeti Islam është bashkësia e devotshmërisë dhe e përkushtimit ndaj Allahut dhe anëtarët e tij e marrin forcën e tyre nga njëri-tjetri në vepra të devotshmërisë dhe virtytit. Lidhjet që bazohen në devotshmëri dhe virtyt janë lidhjet më të forta dhe janë këto lidhje që janë të mira për njerëzimin. Forca e komunitetit musliman qëndron në përkushtimin e tij ndaj vlerave të mirësisë, moralit dhe devotshmërisë. Ramazani lë gjurmë të të gjitha këtyre vlerave në umetin Islam.

#### **5 - Një ndjenjë e re e kujdesit dhe simpatisë:**

Agjërimi në muajin e Ramazanit na ndihmon të kuptojmë vuajtjet dhe dhimbjet e të varfërve dhe nevojtarëve. Nga uria dhe etja jonë vullnetare, ne kuptojmë se çfarë do të thotë të jesh i privuar nga nevojat themelore të jetës. Ramazani quhet muaji i bamirësisë dhe simpatisë. Mësojmë se si të jemi më të sjellshëm dhe bujarë në këtë muaj. Shumë muslimanë gjithashtu e paguajnë zekatin e tyre në muajin e Ramazanit.



## **6 - Xihadi ose përpjekja:**

Agjërimi i Ramazanit dhe Xihadi, që të dyja janë bërë obligim në të njëjtin vit, pra në vitin e dytë të hixhretit në Medine. Agjërimi përgatit për vështirësi dhe sakrifica. Këto janë dy gjëra të rëndësishme pa të cilat Xihadi nuk është i mundur. Muslimanët mësojnë në Ramazan se si të luftojnë kundër forcave të së keqes në veten e tyre, në shoqërinë përreth tyre dhe në botë në përgjithësi.

## **7 – Takvallëku (dovotshmëria):**

Për të përmbledhur të gjitha dhuntitë morale dhe shpirtërore të Ramazanit, mund të themi se Ramazani na jep dhuratën e madhe të takvasë (devotshmërisë). Takvaja është shuma totale e jetës islame. Ai është virtyti më i larti nga të gjitha virtytet në skemën islame të gjërave. Do të thotë vetëdije ndaj Zotit, devotshmëri, frikë dhe drojë ndaj Allahut, si dhe nënkupton nënshtrim ndaj Allahut dhe përkushtim të plotë ndaj gjithçkaje të mirë dhe refuzim të gjithçkaje që është djallëzore dhe e keqe.



## Çka pas Ramazanit?

Pas përfundimit të muajit të agjërimit, muslimanit i kërkohet të mbajë gjallë shpirtin e Ramazanit aq sa mundet. Për më tepër, nëse atij ose asaj i kanë humbur disa ditë të Ramazanit pa i agjëruar, me arsye të pranueshme, duhet të nxitojë për t'i kompensuar ato.

Pra, pas Ramazanit duhet t'i kemi parasysh gjërat që vijojnë:

### **1 - Kompensimi i ditëve të humbura të agjërimit:**

Muslimani duhet të nxitojë për të kompensuar ditët e humbura të agjërimit të Ramazanit, nëse ka humbur diçka prej agjërimit për arsye të pranueshme (shariatikisht) siç janë: sëmundja, udhëtimi ose menstruacionet në rastin e grave.

### **2 - Agjërimi i gjashtë ditëve të Shevalit:**

Është shumë e rekomanduar nga Suneti që një musliman të agjërojë gjashtë ditë në muajin Sheval. Agjërimi i gjashtë ditëve të Shevalit sjell shpërblim dhe bekim të madh nga Allahu i Madhëruar. Transmetohet se Pejgamberi ﷺ ka thënë: “Kush agjëron muajin e Ramazanit dhe e pason atë me (agjërimin) gjashtë ditë të Shevalit, është sikur të ketë agjëruar tërë vitin”. (Muslimi)

Këtu, është e rëndësishme të theksohet se nuk është e nevojshme që një musliman të agjërojë gjashtë ditët e Shevalit radhazi. Përderisa dikush i ka agjëruar gjashtë ditë, radhazi ose veçmas, ai e ka plotësuar agjërimin dhe do të marrë të njëjtin shpërblim, insha Allah.





### 3 - Ruajtja e frymës së Ramazanit:

Një musliman nuk duhet të kursejë përpjekjet për të mbajtur gjallë frymën e Ramazanit edhe gjatë muajve të tjerë të vitit, e kjo, me anë të:

- Kërkimit të mbështetjes nga Allahu, lutjes së të Plotfuqishmit që ta udhëzojë në rrugën e drejtë dhe ta ndihmojë të qëndrojë i qëndrueshëm në besim.
- Zbatimi i agjërimit vullnetar pas Ramazanit, pasi që është sunet që muslimanët të agjërojnë vullnetarisht edhe pas Ramazanit. Ditët në të cilat rekomandohet agjërimi vullnetar janë: gjashtë ditë të muajit Sheval, dita e Arafatit (9 Dhul-Hixhe - me kusht që personi të mos jetë në Arafat si haxhi), dita e 10-të e Muharremit, 3 ditët e mesme të muajit hënor (ditët e bardha), si dhe të hënat dhe të enjtjet.
- Vazhdimi i faljes së namazit të natës edhe pas Ramazanit.
- Vazhdimi i leximit, dëgjimit dhe reflektimit mbi Kuranin.
- Vazhdimi i kujdesit për të varfrit dhe nevojtarët.
- Vazhdimi i ofrimit të adhurimeve tjera nafie (vullnetare).
- Vazhdimi i dhikrit të shumtë dhe lutjes së Allahut të Madhëruar për falje.
- Shmangia e ndalesave shariatike dhe veprave të ndaluara.





لجنة الدعوة الإلكترونية

E-Da'wah Committee

[www.edc.org.kw](http://www.edc.org.kw)



Literatura  
**ISLAME**